

Hermeneutical Nature of Text in Jacques Derrida's Thought



Philosophy

Keywords: Text, trace, sign, différance, pharmakon, hermeneutics.

Ledian Rusta

University of Tirana, Tirana, Albania.

Abstract

This paper unfolds the philosophical thought of Jacques Derrida regarding his hermeneutical consideration about the concept of text (written word). The matter initially addressed is related to his criticism concerning Plato's metaphysical position, which appears in the spoken word (the dialogue), as the proper form of unfolding the truth. As a criticism towards him, Derrida uses the concept of writing, providing a few characteristics under the term Pharmakon, as well as emphasizing its anti-metaphysical nature, relying on the qualities it consists of, such as, transcendentalism, autonomy, and its particular condition such as différance. In a more thorough hermeneutical review, the author proposes that writing should not be perceived as a simple physical material sign, under the example of presence, on which the metaphysics lies, but as différance expressed through the concept of trace. As a result, the constant hermeneutical nature of the trace and its meaning, depending on the existential experience of the interpreting subject, outlines yet another particular relationship with the understanding and the truth which the text expresses. This truth unfolds as fully dynamic, and by not being materialized in the graphic sign of the text, it gains its meaning from the interpreting subject's experience itself.

1. Natyra e dyfishtë e shkrimit: Farmakomi

Nisur nga kritikën e shumta që Derrida i adreson konceptit të fonocentrizmit dhe logocentrizmit, me përfaqësues tipik mendimin e Platonit, ai rreket të trajtojë natyrën hermeneutike të shkrimit apo tekstit. Në një vepër të titulluar në mënyrë metaforike, *La Pharmacie de Platon* (1968), Derrida analizon natyrën hermeneutike të tekstit të shkruar. Sipas tij, nisur nga natyra që gëzon shkrimi ai na shfaqet si një entitet farmaceutik me dy veti të kundërta: si shërues dhe si helmues. Për këtë arsye ai e perifrason natyrën e shkrimit si farmakom. Kështu *“farmacea (Pharmákeia) përbën edhe një emër të zakonshëm që tregon dhënien e pharmakom, të drogës: të barit dhe/apo të helmit...pak më përpara, Sokrati e krahason me një drogë (pharmakom) tekstet e shkruara që Fedoni ka marrë me vete. Ky pharmakom, ky “ilaç”, ky filtër, njëkohësisht shërues dhe helm, futet tashmë në trupin e diskursit me të gjithë shumëkuptimshmëritë e tij. Kjo magjepsje, kjo cilësi e magjepsjes, kjo fuqi e magji, mundet të jenë-herë pas here apo njëkohësisht- të mira dhe të këqija”* (Derrida, 2007, p. 57-58). Në të vërtetë ky term i fundit ka një kuptim të dyfishtë që i shërben Derrida-s për të përfaqësuar natyrën që ka shkrimi dhe raportin që krijon me fjalën e folur. Fillimisht kuptimi i parë i termit *“farmakom”* është të qenit ilaç. Po përse cilësohet si i tillë? Sipas tij, shkrimi lind nga disa nevoja për të zgjidhur disa probleme (qoftë edhe materiale) që fjala e folur nuk i zgjidh dot. Në këtë drejtim, përdorimi i shkrimit vjen pas një krize që krijon fjala e folur për të përçuar mendimin përgjatë procesit të të kuptuarit. Në këtë optikë, teksti kërkon të zgjidh problemin e ruajtjes së dijes pasi *“ky ilaç është mirëbërës, prodhon dhe mbron, grumbullon dhe shëron, rrit dijen dhe pakëson harresën”*- (Derrida, 2007, p. 87). Nisur nga kjo situatë, përmes shkrimit, informacioni ruhet më mirë dhe në mënyrë më të sigurt përgjatë kohës duke qenë më i lehtë për tu zhvendosur materialisht. Mirëpo paradoksalisht më pas ai krijon probleme që rrjedhin nga vetë natyra e tij. Ashtu si vetë ilaçi në kuptimin farmaceutik krijon efekte anësore po ashtu edhe shkrimi për analogji shndërrohet në helm. Për analogji me këtë alegori, shkrimi është ilaç se zgjidh disa probleme të fjalës së folur por krijon edhe disa probleme që i hap vetë: pra ai kthehet në të kundërtën e vet, në helm. Më konkretisht një tekst apo shkrim kur i drejtohet lexuesit mund të krijoj keqkuptime në leximin dhe interpretimin e tij. Për këtë arsye, ai na krijon probleme duke u shndërruar në helm. Për këtë arsye, sipas Derrida-s, *“pharmakom nuk mund të jetë kurrë vetëm mirëbërës. Për shkak të dy motiveve dhe në dy nivele në thellësi të ndryshme. Kryesisht sepse thelbi apo vetia mirëbërëse i një farmakomi nuk pengojnë së qeni të dhimbshëm. Protogora e klasifikon pharmakomin mes gjërave që mund të jenë në të njëjtën kohë të mira (agathá) dhe të dhimbshme (anará)”* (Derrida, 2007, 90). Megjithatë duke ndjekur analogjinë me botën e farmaceutikës përsëri shkrimi mund të shërbejë si një entitet që shëron vetveten duke u kthyer në një vaksinë. Në kuptimin mjekësor, vakcina krijon një autoimunitet dhe vetë shkrimi zotëron këtë natyrë pasi po

përmes tij ai mund të zgjidh keqkuptimet që krijon vetë. Kështu, për shembull, nëse shkrimi i parë krijon një keqkuptim nga ana e lexuesit, autori mund të shkruaj një tekst të dytë për të qartësuar keqkuptimet që janë ngjallur nga qëndrimi apo interpretimi i lexuesve të ndryshëm. Megjithatë përsëri këtu shtrohet një pyetje: po sikur shkrimi i dytë të lind apo krijoj përsëri keqkuptime, njëlloj si shkrimi i parë? Çfarë duhet bërë? Sigurisht kuptohet që është e mundur që autori përsëri të shkruaj të tekst të dytë por do të përballlet me të njëjtin problem. Kështu mesazhi që shfaqet shpreh se shkrimi i tekstit dhe puna me interpretimin e tij është një çështje që nuk shterron kurrë. Nëse në të vërtetë mbyllet një debat i tekstit atëherë shfaqet një debat i pashtershëm mbi tekstin e shkruar. Realisht kjo është vetia që gëzon vetë procesi i interpretimit dhe komunikimit përmes tekstit të shkruar. Në mënyrë metaforike mund të dalim me një përfundim të rëndësishëm lidhur me detyrën dhe punën hermeneutike lidhur me tekstin: puna hermeneutike është një detyrë që nuk përfundon. Puna hermeneutike është kështu një proces i hapur dhe teorikisht i pafundëm për shkak se në gjenezë të saj ekziston interpretimi dhe vetëm interpretimi i lexuesit.

2. Diferenca dhe gjurma

Kritika e Derrida-s kundrejt Platonit lidhur me dialogun si formë e fjalës së folur lidhej me faktin se kjo e fundit themelohej në një perspektivë tërësisht metafizike. Në këtë drejtim, përsiatja filozofike e Platonit krijonte një konceptim metafizik të objektit të hermeneutikës, dialogut (fjala e folur). Për këtë arsye, Derrida i drejton një kritikë hermeneutike duke e adresuar përmes entitetit të tekstit, shkrimit. Fillimisht ai nisur nga kritikën ndaj fjalës së folur ai mendon se shkrimi ka një natyrë të ndryshme dhe gëzon disa cilësi. Së pari, shkrimi riprodhon në mënyrë të pafundme shenjën pa pësuar deformime materiale. Si rrjedhim, nisur nga epërsia e tij, një tekst mund të riprodhohet pafundësisht duke i qëndruar besnik nga ana grafike tekstit fillestar që shërben si model për riprodhim. Së dyti, teksti nga ana hermeneutike zotëron një natyrë transendentale. Që në momentin kur autori i tekstit shkruan një vepër kjo e fundit fiton një autonomi duke u subjektivizuar (duke u bërë subjekt më vete). Tani më, teksti përshkon një jetë të vetën në mënyrë të pavarur nga autori që e shkruajti. Për këtë arsye, kjo pavarësi që fiton shkrimi e bën atë transendental duke e shkëpur nga varësia e autorit që e prodhoi. Në këtë situatë krijohet një gjendje papërcaktueshmërie dhe merr jetë situata e interpretimit hermeneutik të tekstit nga ana e lexuesit. Pra është lexuesi që i jep një kuptim hermeneutik vetë tekstit. Siç thekson edhe Ricoeur se “*marrësi i një teksti përbën një marrës të mundshëm*” (Ricoeur, 2006, 55).

Ndërkohë në situatën e fjalës së folur raporti mes autorit dhe përmbajtjes së mesazhit është krejt i kundërt. Në situatën e dialogut ka një varësi ekzistenciale mes folësit dhe mesazhit që ai shpreh, pra nëse nuk ekziston folësi, nuk ekziston as mesazhi. Si pasojë, në dialog nuk ekziston një distancë kohore ndërsa me shkrimin ndodh saktësisht e kundërta. Kështu situata e tekstit të shkruar përbën dhe formon një botë më vete të pavarur nga autori që e ka shkruar.

Më tej, lidhur me tekstet, shfaqet një veçori tjetër tepër e rëndësishme për punën e hermeneutikës. Në lidhje me këtë Derrida mendon se shkrimi është i pakontrollueshëm (i shpëton autorit dhe kohës kur ai është shkruar). Për të “*shkrimi i shpëton kontrollit të atij që e ka prodhuar empirikisht dhe kjo ndodh pasi janë në lojë të tjerët pasi atë e kontrollojnë të tjerët*” (Derrida, 1997, 11) përmes përvojës së tyre duke e interpretuar. Për këtë arsye ai është transendental duke theksuar faktin se ai nuk është i ngurtë. Në këtë aspekt, për të, shkrimi dhe teksti nuk mund të tkurren thjesht në një gramatikë fizike të shenjave. Shkrimi nuk përbën thjesht një paraqitje me një natyrë grafike empirike. Kështu tek shkrimi situata sesi artikullohet të kuptuarit përfaqësohet nga ai me termin “*différance*”, çka përbën një situatë hermeneutike të hapur e dinamike. Sipas tij ky koncept nuk lidhet me një fjalë apo koncept të veçantë dhe që mundet të shquhet thjesht përmes shkrimit apo leximit të shkrimit. Shkrimi në realitet për të është jo diferenca e pranisë fizike por diferenca e vetë diferencës pasi është subjekti që e interpreton duke thyer kontekstin material ku shenja shfaqet. Pra “*një shenjë e shkruar, në kuptimin vijues të*

termit, përbën, pra, një shenjë që mbetet, që nuk shterret në të tashmen e shenjimit të saj dhe që mund t'i jap udhë një përsëritje në mungesë përtej pranisë të subjektit empirikisht të përcaktuar i cili e gëzon, në një kontekst të caktuar, e transmetuar apo e prodhuar” (Derrida, 1997, 14-15). Kjo bën që formës grafike të mos i jepet një objektivitet të kulluar dhe kuptimi të mos lidhet materialisht me shenjën grafike. Nisur nga këto aspekte, Derrida-ja beson se shkrimi ndryshe nga qasja e Platonit lidhur me fjalën e folur zotëron një natyrë anti-metafizike.

Nga ana tjetër, përpjekja e Derrida-s ku mohohet fakti se gjuha ruan një adresues objektiv, një referencë kundrejt realitetit, bën të mundur ekzistencën e një interpretim dinamik duke e bërë çdo shenjë një interpretim potencial që na sjell një të kuptuari të caktuar. Duke njohur këtë fakt atëherë kuptimi i një teksti kapërcen vetë autorin që e ka krijuar (teksti bën një jetë të pavarur) duke përbërë sipas Gadamer-it konkluzionin se “të kuptuarit nuk përbën një akt riprodhues por edhe krijues” (Gadamer, 2001, 346).

3. Diferenca ontologjike përmes tekstit

Nisur nga konsideratat e Heidegger-it se “qenia ndodh në gjuhë” (Heidegger, 1995, 31) dhe ideja e Gadamer-it se “qenia që mund të kuptohet është gjuha” (Gadamer, 2001, 542.), Derrida-ja kërkon të eci në të njëjtin shteg duke përvijuar idenë e një hermeneutike që shpaloset dhe artikullohet përmes tekstit. Për të kuptuar këtë situatë tek mendimi i tij duhet të shquajmë marrëdhënien e tekstit me konceptin e qenies apo sesi shfaqet kjo e fundit përmes tij. Për analogji duket se Derrida-ja i ndikuar edhe nga Heidegger-i në konceptin e diferencës ontologjike të qenies me entin, krijon konceptin e diferencës të qenies me tekstin. “Tashmë ngjan se lloji i pyetjes që i jemi adresuar përsëri, është, le të themi, i llojit heideggerian, dhe se diferenca duket se na udhëheq në diferencën ontiko-ontologjike. Na këshillohet ta kemi mirë parasysh këtë gjë” (Derrida, 1982, 10). Në këtë drejtim, temi *différance* duhet analizuar edhe në këtë këndvështrim. Sipas Derrida-s duke qenë se nuk mund të ekzistojë një sequencë harmonike fjalësh atëherë qenia është e diferencuar dhe e dallueshme ndaj fjalës duke u shfaqur si gjurmë. Kështu, në këtë konsideratë të parë, ai kërkon të shpalos një qasje antimetafizike duke kaluar nga koncepti i shenjës si diçka grafike dhe ngurtë që simbolizon idenë e pranisë në atë të gjurmës si një entitet hermeneutik. Megjithatë kalimi apo zëvendësimi i shenjës me gjurmën nuk përbën thjesht një rokadë pasi shfaqja e mendimit të tij rreth situatës së *différance* duket se të shtyn në një botëkuptim tërësisht metafizik. Si pasojë, Derrida-ja parpiket të kritikojë metafizikën kur mendon se shkrimi e diferencon qenien apo të vërtetën si diçka objektive. Pra nëse qenia konceptohet në këtë perspektivë si gjurmë atëherë kjo të shtyn në një qasje me thelb antimetafizik. Nisur nga kjo kritikë mund të themi se procesi interpretues nuk mund të zë udhë nëse nuk ekziston paraprakisht një shkrim, pra nuk mund të ketë një interpretim të objektit nëse nuk ekziston vetë objekti për tu interpretuar (teksti). Në këtë drejtim, nëse shenja është e dhënë në kuptimin material dhe empirik, gjurma përbën një situatë e ndërtuar nga procesi që rrjedh nga interpretimi i subjektit. Pra nëse themi se qenia diferencohet në gjuhë atëherë të krijohet ideja apo duket se artikullohet qëndrimi se realisht nuk ekziston një qenie e vërtetë dhe e plotë dhe kjo nuk mund të shfaqet si e tillë përmes shkrimit. Në një kuptim më të thellë duhet pranuar se nuk është thjesht shkrimi që diferencon qenien por se qenia ekziston paraprakisht si diferencë dhe përmes shkrimit ajo shfaq veten e saj si e interpretuar dhe e interpretueshme historikisht. Në këtë optikë, edhe koncepti i gjurmës kuptohet ndryshe. Kështu gjurma nuk merr trajtën e hiçit por të ndryshimit apo të kalimit nga qenia si e diferencuar në një tjetër qenie tjetër të diferencuar përmes interpretimit të tekstit. Me këtë, rrjedhimisht, Derrida-ja beson se ideja e gjurmës dhe kuptimit është e përcaktueshme brenda *différance* dhe kjo e fundit nuk mbetet asgjë tjetër vetëm të tregohet si e pamendueshme edhe e pamundur, pra as si ekzistencë e as si esencë. “Tashmë kemi theksuar se *différance* nuk është, nuk ekziston, nuk është prania-e të qenit (në) çfarëdo lloj forme; e jemi të shtyrë të theksojmë gjithashtu edhe gjithçka që nuk është, pra gjithçka; e si pasojë që nuk gëzon as ekzistencë, as esencë” (Derrida, 1982, 6). Në këtë kuptim, thelbi i termit *différance* nuk përbën një

koncept apo diçka të ngurtë por krijon dhe shfaq një situatë të papërcaktuar hermeneutike që ekziston për shkak të veprimtarisë së subjektit interpretues nisur nga përvoja e tij ekzistenciale.

Conclusions

Derrida's thought unfolds the idea that one way to criticize metaphysics is trying to prove that its existence has a strong connection with Plato's consideration related to the spoken word (the dialogue). It appears that the entire metaphysics lies on the idea that the meaning of the sign derives from its own material presence and it creates a solid relation in conveying the truth as something rigid. Therefore, Derrida unfolds the anti-metaphysical characteristics and nature of the writing (the text), such as its autonomous existence, its transcendental, the dynamic situation of the relation between truth and trace, etc. Thus, through the writing and its nature as *différance*, a new hermeneutical relation is created, where the truth it expresses rests in the modes of the trace that appears as a difference and as a dynamic semantic distinction. In such situation, the truth doesn't lie in the text as a material sign, but it appears as a differentiated trace of the interpretative subject activity itself. The truth, expressed in the text, appears constantly as the result of the interpretative and dynamic work of the subject, therefore it doesn't speak by itself, but it comes into being only through these existential experiences of the subject itself.

Referencat

1. Derrida, J. (2007). *La farmacia di Platone*. Milano: Jaca Book
2. Gadamer, H. (2007). *Lettura, scrittura e partecipazione*. Ancona: Transeuropa
3. Derrida, J. (1982). *Margins of philosophy*. Great Britain: The Harvester Press
4. Gadamer, H. (2001). *Verita e metodo*. Milano: Bompiani
5. Derrida, J. (1997). *Limited Inc.*. Milano: Cortina
6. Heidegger, M. (1995). *Lettera sull'umanismo*. Milano: Adelphi
7. Ricoeur, P. (2006). *La sfida semiologica*. Roma: Armando